



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 28.1.2025

Nr: 47

Ora: 10:00

**VENDIM**

**MBI**

**PËRDORIMIN NË PROCESIN ZGJEDHOR TË DISA MATERIALEVE DHE  
PËRCAKTIMIN E KARAKTERISTIKAVE TË PËRGJITHSHME TË TYRE NË  
PËRDORIM PËR PROCESIN E VOTIMIT NGA JASHTË VENDIT**

Në mbështetje të nenit 19 pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 24 pika 1, nenit 25/1 dhe të nenit 99 e vijues, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe Vendimit nr.13, datë 12.11.2024 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullave për procedurën e votimit nga jashtë vendit”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**VENDOS:**

1. Në kuadër të administrimit të procesit zgjedhor për votimin nga jashtë vendit, të përdoren kutitë e votimit nga jashtë si dhe materialet e tjera të përshkruara në lidhjen 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Përcaktimi i sasive të kutive të votimit nga jashtë apo materialeve të tjera, si dhe i kriterëve dhe specifikimeve teknike, veçmas atyre që përmban lidhja 1, bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit përkatës në fushën e prokurimeve publike.
3. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 28.1.2025 Nr: 47  
Ora: 10:00



“Mbi përdorimin në procesin zgjedhor të disa materialeve dhe përcaktimin e karakteristikave të përgjithshme të tyre në përdorim për procesin e votimit nga jashtë vendit”



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**Lidhja 1**

<b>Materiali zgjedhor</b>	<b>Përdorueshmëria</b>	<b>Karakteristika të përgjithshme</b>	<b>Karakteristika të veçanta</b>
<b>1.Vulat me Kod sigurie</b>	Shërbejnë për vulosjen e të gjitha kutive të votimit nga jashtë dhe të materialeve zgjedhore përgjatë procesit zgjedhor dhe verifikimit pas zgjedhor për të garantuar integritetin e fletëve të votimit nga jashtë dhe të dokumentacionit zgjedhor.	<ol style="list-style-type: none"><li>1.Vula e sigurisë duhet të jetë rezistente dhe e testuar për një forcë thyerje, tërheqje, përkulje dhe të jetë sipas standardeve të zbatueshme.</li><li>2.Vula është e montueshme me një proces të vetëm pa nevojën e mjeteve ndihmëse.</li><li>3.Vula duhet të jetë e projektuar për një përdorim dhe nuk hapet aksidentalisht.</li><li>4.Çdo përpjekje për të ndërhyrë me anë të ushtrimit të nxehtësisë, forcës mekanike (duke futur një mjet, duke e shpuar, përkulur apo tërhequr) apo kimikateve (tretësve) është e dallueshme nëpërmjet shenjave që lë.</li><li>5.Ajo duhet të jetë rezistente ndaj agjenteve atmosferik dhe fizik.</li></ol>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Vula e sigurisë do të jetë me qëndrueshmëri këputjeje për të garantuar paprekshmërinë/ mos hapjen aksidentale në çfarëdolloj forme të kutive të votimit nga jashtë.</li><li>2. Përbërësit e ndryshëm të vulës nuk plasariten, nuk deformohen apo nuk çngjyrosen për shkak të ndryshimeve atmosferike.</li><li>3. Vula duhet të ketë të shënuar këta elementë: Emri i institucionit: “KQZ”.<ul style="list-style-type: none"><li>• Numri serial i vulës i cili është unik, nga 6 deri në 8 shifra.</li><li>• Barcodi linear / QR code duhet të jetë dhe i qëndrueshëm në trupin e vulës duke siguruar mos fshirjen e tij nëpërmjet fërkimit</li></ul></li></ol>





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

		6. Ngjyra përcaktohet në varësi të procesit zgjedhor dhe procesit të punës (ngjyrë të veçantë për vultat që do të përdoren për mbylljen e kutive të votimit nga jashtë dhe ngjyrë të ndryshme për vultat rezervë).	apo formave të ngjashme 4. Numri i shifrave të variojë sipas konsumit, shifrat nuk duhet të jenë të përsëritshme duke përfshirë edhe ato të përdorura më parë.
<b>2. Kutitë e votimit</b>	<p>Kutitë e votimit nga jashtë do të përdoret për të mundësuar depozitimin e dokumentacionit zgjedhor të zgjedhësve që votojnë nga jashtë vendit për subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në procesin zgjedhor, veçmas për çdo qark.</p> <p>Kutitë e votimit nga jashtë janë 4 lloje:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Kuti të votimit nga jashtë;</li><li>2. Kuti rezervë të votimit nga jashtë;</li><li>3. Kuti e posaçme e votimit nga jashtë;</li><li>4. Kuti rezervë e posaçme e votimit nga jashtë.</li></ol>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Kutitë e votimit nga jashtë të jenë të pa palosshme, të hapura vetëm nga një anë, në të cilën vendoset kapaku përkatës dhe nëpërmjet të cilit mundësohet hedhja e dokumentacionit zgjedhor.</li><li>2. Kutitë e votimit nga jashtë janë të tejdukshme nga të paktën katër anët e saj.</li><li>3. Kutitë e votimit nga jashtë duhet të kenë aftësi për të mbajtur ngarkesa të brendshme pa u deformuar.</li><li>4. Pjesa e sipërme e kutive (kapaku) të jetë e qëndrueshme ndaj presionit të jashtëm.</li><li>5. Këto kuti duhet të mbyllën me kapak i cili lidhet me kutinë me 4 vula me kode sigurie.</li></ol>	<ol style="list-style-type: none"><li>1. Kapaciteti mbajtës (volumi) i kutive të votimit nga jashtë të jetë të paktën 100 litra., afërsisht e barabartë me kapacitetin e 1.000 dokumentacioneve (me përmasa A3) të palosura dhe të jetë me transparencë të lartë për të vëzhguar lehtësisht mos tjetërsueshërinë e votës.</li><li>2. Forma e kutive të votimit nga jashtë të jetë prizëm gjysmë piramide me lartësi të brendshme 60 cm (+/-2) cm.</li><li>3. Kapaku i kutive të votimit nga jashtë:<ul style="list-style-type: none"><li>• të ketë hapësirën e posaçme ku futet dokumentacioni zgjedhor nga jashtë,</li></ul></li></ol>

Data: 28.1.2025 Nr: 47  
Ora: 10:00



“Mbi përdorimin në procesin zgjedhor të disa materialeve dhe përcaktimin e karakteristikave të përgjithshme të tyre në përdorim për procesin e votimit nga jashtë vendit”



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

		<p>6. Kapaku duhet të ketë një të çarë nëpërmjet të cilës të mund të futet dokumentacioni zgjedhor i ardhur nga jashtë, por njëkohësisht kjo e çarë nuk duhet të lejojë nxjerrjen e këtij dokumentacioni.</p> <p>7. E çara në kapakun e kutive të votimit nga jashtë duhet të mundësojë funksionalitetin e mbylljes me vulë me kod sigurie.</p>	<ul style="list-style-type: none"><li>• të ketë dimensione që përputhen me kutitë e votimit nga jashtë, dhe</li><li>• të mbyllet pa krijuar hapësira me buzët e kutive të votimit nga jashtë.</li></ul> <p>4. Pjesa e hapur e kapakut nëpërmjet të cilës hidhet dokumentacioni zgjedhor të mbyllet të paktën me një vulë sigurie në përfundim të procesit të votimit.</p>
<b>3. Etiketa e sigurisë</b>	<p>Etiketa e sigurisë shërben përvulosjen/ matrikullimin e materialeve/ambienteve të ndryshme zgjedhore gjatë gjithë proceseve të punës.</p>	<p>1. Etiketa e sigurisë duhet të ketë të gjithë elementët e sigurisë për të mbrojtur sendet/asetet/ ambientet nga çdo ndërhyrje e personave të tjerë.</p> <p>2. Etiketa e sigurisë është e montueshme me një proces të vetëm pa nevojën e mjeteve ndihmëse. Ajo është projektuar për një përdorim dhe nuk hapet aksidentalisht.</p> <p>3. Etiketa të ketë veti gjurmlënëse të dallueshme që lë etiketa në trupin e saj ose në sipërfaqen e rrafshët ku do të vendoset.</p>	<p>1. Trupi i etiketës duhet të jetë i përberë nga material letër plastike (polietilen) me një shtrese dhe i personalizuar me logon e KQZ-së dhe të ketë numër serial unik me 6- 8 shifra.</p> <p>2. Trupi i etiketës së sigurisë të bëjë mundur etiketimin e të dhënave, si: të përmbajnë fjalën “KQZ” dhe kodin e sigurisë me numër rendor 6-8 shifror.</p> <p>3. Numri i shifrave të variojë sipas konsumit, shifrat nuk duhet të jenë të përsëritshme duke</p>

Data: 28.1.2025 Nr: 47  
Ora: 10:00



“Mbi përdorimin në procesin zgjedhor të disa materialeve dhe përcaktimin e karakteristikave të përgjithshme të tyre në përdorim për procesin e votimit nga jashtë vendit”



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

			<p>përfshirë edhe ato të përdorura më parë.</p> <p>4. Gjithashtu trupi i etiketës duhet të ofrojë mundësinë e vendosjes të opsionit “Barcode” për aplikacione të lëvizshme.</p>
--	--	--	---

